



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **24.07.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kritereve të zbatimit të masës së sigurimit personal, e caktuar me vendimin nr. 81, datë 25.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personave nën hetim **Luc Melaj, Emanuel Melaj, Gëzim Camaj, Tonin Melaj, Bashkim Çokaj.**”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 238 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 88, datë 25.07.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit ndaj **personit nën hetim Luc Melaj**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*” kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “*Falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave dhe i vizave*” kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “*Grup i strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” të parashikuara nga nenet 298/1 - 28/4; 189/1 - 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të K.Penal; “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*” kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal; “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1/1 i Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “**Arrest në burg**” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin Nr. 81, datë 21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Vazhdimin e zbatimit ndaj personit nën hetim **Emanuel Melaj**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, e kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “**Arrest në shtëpi**” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin Nr. 81, datë 21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Urdhërohet personi nën hetim Emanuel Melaj që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në adresën: ****.
4. Vazhdimin e zbatimit ndaj personit nën hetim **Gëzim Camaj**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, e kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “**Arrest në shtëpi**” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin Nr. 81, datë

21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

5. Urdhërohet personi nën hetim Gëzim Camaj që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në adresën: ****.
6. Vazhdimin e zbatimit ndaj personit nën hetim **Tonin Melaj**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorim i detyrës*”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin Nr. 81, datë 21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
7. Urdhërohet personi nën hetim Tonin Melaj që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në adresën: ****.
8. Vazhdimin e zbatimit ndaj personit nën hetim **Bashkim Çokaj**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorim i detyrës*”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin Nr. 81, datë 21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
9. Urdhërohet personi nën hetim Bashkim Çokaj që të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në adresën: ****.
10. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personi nën hetim Luc Melaj, të dërgohet menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
11. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
12. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 25.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar